Kronikë

Shkodrani arrestohet në Morinë, nga Kosova në Shqipëri me dy pistoleta në çantë (EMRI)

Një 26 vjeçar është arrestuar pasi po tentonte të fuste nga Kosova dy pistoleta në Shqipëri.

Redaksia
28 Gusht, 10:30 | **Përditësimi: 28 Gusht, 10:34**

Share

Një 26 vjeçar është arrestuar pasi po tentonte të fuste nga Kosova dy pistoleta në Shqipëri. Report TV mëson se në pranga ka rënë Ilirjan Skacaj, 26 vjeç, banues në Shkodër

Njoftimi i policise

LEXO EDHE:
Mbyllet votimi për Primaret e 'Rithemelimit' për Bashkinë e Kukësit, ja cili u shpall fitues! Kryetari i degës: Ai s'jeton këtu, bëra mirë që u tërhoqa

Si rezultat i intensifikimit të kontrolleve me përzgjedhje, për shkak të fluksit të qytetarëve në hyrje/dalje, me qëllim parandalimin dhe goditjen e trafiqeve të paligjshme dhe krimeve të tjera kufitare, shërbimet e Policisë Kufitare të Morinës kanë finalizuar operacionin policor të koduar "Transcendence", si rezultat i të cilit u parandalua dhe u godit një tjetër rast i tentativës për të trafikuar armë zjarri, nga Kosova, drejt Shqipërisë.

Në kuadër të këtij operacioni, është kapur në flagrancë dhe është arrestuar nga specialistët për Hetimin e Trafiqeve të Paligjshme dhe Narkotikëve të DVP Kukës, shtetasi I. S., 26 vjeç, banues në Shkodër.

Gjatë kontrollit në vijë të dytë, në hyrje të RSh-së, 26-vjeçarit i janë gjetur me vete dhe në çantë, 2 armë zjarri pistoleta, të cilat dyshohet se do të trafikoheshin në vendin tonë.

Në vijim të veprimeve procedurale për këtë rast, është koordinuar me Policinë e Shkodrës, ku është ushtruar kontroll në banesën e shtetasit I. S., në Shkodër, ku janë gjetur një tjetër armë zjarri pistoletë, fishekë luftarak, një sasi lëndë e dyshuar narkotike cannabis sativa, 400 fara të dyshuara të kësaj bime dhe 2 targa automjeti, të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale, së bashku me 2 pisoletat që iu gjetën shtetasit I. S., në PKK Morinë.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, për veprime të mëtejshme, për veprat penale "Trafikimi i narkotikëve", "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit" dhe "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve".



S.G/KT/Shqiptarja.com

TAG: Ilirjan Skacaj | morine | Kukes

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Së shpejti Asambleja e PS-së, a duhet të ketë ndryshime në qeveri?

Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

Qëlluan me armë efektivët shqiptarë në kufirin me Kosovën, gjykata lë në burg gjashtë shtetasit sirianë! U arrestuan 3 muaj më parë

27 Gusht, 15:18

Gara për bashkinë e Kukësit, Rithemelimi mban sot Primaret

27 Gusht, 09:49

Si e dogji Berisha rastin e fundit!

Dritan Hila

26 Gusht, 18:02

Morinë/ Tentoi të fuste në vendin tonë mbi 32 mijë euro të padeklaruara, vihet nën hetim 37-vjeçari

26 Gusht, 10:44

Kosova 'zbarkon' drejt bregdetit shqiptar, fluks në Morinë, mbi 40 mijë vetëm gjatë mëngjesit

26 Gusht, 09:39

Mero Baze: Përse Edi Rama nuk sfidohet nga opozita?

Mero Baze

25 Gusht, 20:53

EMRI/ Tentoi të fuste në Shqipëri mallra kontrabandë, arrestohet në Morinë 39-vjeçari nga Kosova

25 Gusht, 10:57

Zgjedhjet në Kukës, asambleja e PS-së miraton kandidaturën e Albert Halilajt për kryetar bashkie

24 Gusht, 17:48

Ylli Pata: Pasojat politika të grackës së Kukësit për Berishën

Ylli Pata

23 Gusht, 21:57

Zgjedhjet në Kukës, Rithemelimi primare më 27 gusht! Admir Sinamati tërhiqet nga gara, Tabaku: Lëvizje e zgjuar

23 Gusht, 13:09

Zgjedhjet në Kukës/ KAS rrëzon ankimin e PD, lë në fuqi ndarjen e KQZ për anëtarët e KZAZ

22 Gusht, 15:01

Berisha 'vulos' përçarjen e opozitës në Kukës, nxjerr kandidat nga primaret! PS në garë me Albert Halilajn, PD e ndarë dhe pa konsensus

Benet Beqiri

22 Gusht, 13:37

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje